

VENDIM
Nr. 318, datë 27.4.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTOR PËR TË NDËRMARRË
DHE ZHVILLUAR PROCEDURAT PËR DHËNIE KONCESIONI/PARTNERITETI
PUBLIK PRIVAT, ME OBJEKT NDRIÇIMIN PUBLIK NË TERRITORET E NJËSIVE
ADMINISTRATIVE VENDORE, NË KUADËR TË PROGRAMIT TË EFICIENCËS
SË ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Bashkisë Tiranë dhe Bashkisë Durrës, si autoritete kontraktore, për të marrë në shqyrtim projektin e koncesionit/partneritetit publik privat, të identifikuar dhe të propozuar nga shoqëria “HeSaLight” A/S, për sistemin e ndriçimit të Bashkisë Tiranë dhe të Bashkisë Durrës, në kuadër të programit të eficiencës së energjisë.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë të administrojë procedurat për dhënien me koncesion/PPP, në përputhje me kreun III, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Bashkia Tiranë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama